

INside Trepça

TUR 1 DITOR

Ky tur ofron një vështrim gjithëpërfshirës të historisë dhe gjendjes aktuale të minierave në Mitrovicë, si dhe një mundësi për të përjetuar kulturën dhe mënyrën e jetesës lokale. Së pari, vizita fillon me Parkun Industrial Trepça, i cili është një kompleks kryesisht i braktisur në Mitrovicë. Pas kësaj, ju do të vizitoni Muzeun Kombëtar të Kristaleve dhe Mineraleve, ku mund të shihni një shumëllojshmëri të gjerë të mineraleve nga Trepça dhe minierat e tjera ndërkombëtare. Më pas, do të hyni në nivelet nëntokësore të minierës së Trepçës dhe do të kaloni një përvojë të paharrueshme. Ndërkohë do të shihni procesin e minierave në veprim dhe do të mësoni rreth sfidave dhe rreziqeve të përfshira në miniera. Në fund do të vizitoni Stan Tërgun, një lagje të vogël që ndodhet afër minierës së Trepçës. Aty shihet se si jetonin vendasit në kohën kur miniera lulëzonte. Ky tur njëditor ofron një mundësi të veçantë për të fituar njohuri mbi aspektet historike të Kosovës, duke vëzhguar gjithashtu nga afër se si trashëgimia minerare ka ndikuar në komunitetet lokale në aspekte të ndryshme si në ekonomi, shoqëri dhe kulturë.



OUTside Trepça

TUR 1 DITOR

Ky tur ofron një eksplorim të detajuar të industrisë minerare dhe historisë së Mitrovicës dhe një mundësi për të zbuluar pikat kryesore të këtij qyteti. Duke filluar nga Muzeu i Qytetit, do të fitoni njohuri për historinë dhe kulturën e rajonit, pastaj do të vizitoni qendrën e qytetit, ndërtesat e trashëgimisë kulturore dhe urën simbolike që përfaqëson të kaluarën dhe të tashmen e ndarë të Mitrovicës. Më pas do të vizitoni Monumentin e Minatorëve, një simbol ikonik i pamjes panoramike të Mitrovicës, i vendosur në Kodrën e Minatorëve. Pastaj do të vizitoni Parkun Industrial Trepça, Muzeun Kombëtar të Kristaleve dhe Mineraleve dhe lagjen Stan Tërg. Turi vazhdon në Muzeun e Isa Boletinit dhe Manastirin e Sokolicës, ku vizitorët mund të shijojnë mjedisin e qetë dhe pamjet befasuese të peizazhit. Turi përfundon me një vizitë në fshatin piktoresk Vllahia dhe një vizitë në Parkun e Erës në Bajgorë. Në përgjithësi, ky turne ju ofron një përvojë gjithëpërfshirëse dhe tërheqëse të historisë së Mitrovicës, vendeve industriale, kulturës dhe bukurisë natyrore.



Purple Tour

TUR 2 DITOR

Në ditën e parë të këtij turi ju do të eksploroni historinë dhe kulturën e pasur të Mitrovicës, duke filluar me Muzeun e Qytetit, Urën ikonike të Ibrit, Monumentin e Minatorëve në Kodrën e Minatorëve, Parkun Industrial Trepça, Muzeun Kombëtar të Kristaleve dhe Mineraleve, dhe lagjen Stan Tërg. Më pas, turi do të vazhdojë për në Vushtrri, një qytet antik i njohur si Vicianum, pasuar nga një vizitë në fushën e Betejës së Kosovës dhe në varrin e Sulltan Muratit, që daton nga viti 1389. Dita e parë e këtij udhëtimi mbyllet me një qëndrim nate në Prishtinë ku mund të përjetoni jetën e gjallë të natës. Dita e dytë fillon me një vizitë në lokalitetin arkeologjik të Ulpianës, një qytet antik romak i vendosur pak jashtë Prishtinës, për të vazhduar në Manastirin mahnitës të Graçanicës, një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Turi do të vazhdojë deri në minierën e Kishnicës dhe më pas do të përfundojë në Artanë/Novobërda, ku do të mësoni historinë e pasur dhe trashëgiminë e larmishme kulturore të këtij qyteti. Në përgjithësi, ky udhëtim ju ofron një mundësi ideale për të parë se si burimet natyrore nga minierat e Kosovës kanë lënë një ndikim të thellë në trashëgiminë kulturore të rajonit, dhe gjithashtu kanë ndikuar në dinamikën socio-ekonomike dhe shprehjet kulturore të komunitetet lokale.



ÇFARË PËRFSHIHET:

- Udhërrëfyes turistik lokal
- Transporti
- Hyrja në: Minierën e Trepçës, Muzeun Kombëtar të Kristaleve dhe Mineraleve
- Eksplorimi i trashëgimisë arkitekturore ish-britanike dhe Kishës Saksone të shekullit XIII
- Dreka tradicionale me opsione të mundshme vegjetariane
- Suvenire (kartolina dhe kristale)

- Udhërrëfyes turistik lokal
- Transporti
- Vizita në pjesën veriore të Mitrovicës
- Hyrja në: Muzeun Kombëtar të Kristaleve dhe Mineraleve, Muzeun e Qytetit të Mitrovicës, Muzeun Isa Boletini dhe Manastirin e Sokolicës
- Dreka tradicionale me opsione të mundshme vegjetariane
- Suvenire (kartolina dhe kristale)

- Udhërrëfyes turistik lokal
- Njoftim me rrugëtimin e zhvillimit të ndodhur prej minierave nga Mitrovica në Artanë/Novobërdë
- 1 Natë qëndrim në hotel në Prishtinë
- Transporti
- Hyrja në muze dhe institucione të tjera
- Vizita e vendeve/monumenteve të trashëgimisë kulturore
- Ushqimi (dreka: 2, mëngjesi: 1, darka: 1)
- Suvenire (kartolina dhe kristale)

Pse të bashkoheni me ne?

Zbuloni trashëgiminë magjepsëse të minierave të Kosovës në një udhëtim që eksploron rritjen dhe zhvillimin e vendit nëpër shekuj. Nga miniera ikonë e Trepçës në Mitrovicë deri te miniera historike e Novobërdës, zbuloni rëndësinë e minierave në formësimin e peizazhit, kulturës dhe ekonomisë së rajonit. Shikoni evolucionin e teknologjisë minerare me kalimin e kohës dhe mësoni për ndikimin e minierave në zhvillimin e industrive, infrastrukturës dhe trashëgimisë kulturore.

Ejani, së bashku të eksplorojmë shtegun e minierave dhe të përjetojmë historinë dhe kulturën e pasur të Kosovës në një mënyrë vërtet të paharrueshme!

Na kontaktoni



Visittrepca



Visittrepca



info@visittrepca.com



Visittrepca.com



+383(0)38 748 861

Rreth nesh

“Visit Trepça” është një ndërmarrje sociale e iniciuar nga 7 Arte (OJQ) e dedikuar për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë industriale të Trepçës.

Ne besojmë se kompleksi mineral ka potencialin të jetë një pasuri e vlefshme ekonomike dhe kulturore për komunitetin, ndërtimin e paqes dhe të qëndrueshmërinë së rajonit.

Vizioni ynë është të ruajmë dhe promovojmë trashëgiminë industriale të Trepçës, të krijojmë mundësi ekonomike dhe të fuqizojmë komunitetin përmes praktikave mjedisore të qëndrueshme dhe të përgjegjshme shoqërore. Bashkohuni me ne në përpjekjet tona për të ruajtur dhe promovuar këtë burim të vlefshëm kulturor dhe historik.

Eksplorimi i shtegut të minierave në Kosovë

REPÇA
VISIT

Paketa turistike:

INside Trepça
OUTside Trepça
Purple Tour